FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.qpz.gov.al

Nr.50 27 prill 2009

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.326, datë 12.3.2009	Për disa shtesa në vendimin nr.31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave "Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar ……	2429
Vendim i KM nr.327, datë 12.3.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.78, datë 4.2.2007 të Këshillit të Ministrave "Për masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit të një pakete të veçantë higjieno-sanitare për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë", të ndryshuar ……	2430
Vendim i KM nr.328, datë 12.3.2009	Për disa shtesa në vendimin nr.618, datë 7.9.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar", të ndryshuar……	2430
Udhëzim i MB nr.243, datë 22.4. 2009	Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 160, datë 25.1.2007 "Për procedurat e ndalimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të mjeteve për kundërvajtje administrative", i ndryshuar ……	2431
Vendim i GJK nr.9, datë 1.4.2009	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, nr.371, datë 21.6.1996 të Gjykatës së Rrethit Tepelenë dhe vendimit nr.739, datë 25.4.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër……	2432
Vendim i GJK nr.10, datë 2.4.2009	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.169, datë 4.5.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr.173, datë 27.5.2005 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.330, datë 19.5.2006 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), si të papajtueshme me Kushtetutën ……	2438
Udhëzim i KQZ nr.10, datë 14.4.2009	Për procedurat dhe kriteret e akreditimit të vëzhguesve të subjekteve zgjedhore në KZAZ, KQV dhe VNV, nga KZAZ-ja, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 28.6.2009 …….	2445

VENDIM
Nr.326, datë 12.3.2009

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.31, DATË 20.1.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të pikës 2 të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 "Për buxhetin e vitit 2009", me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 4 të vendimit nr.31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen pikat 4/1 e 4/2, me këtë përmbajtje:

"4/1. Periudha e shërbimit si kujdestar, për invalidin paraplegjik dhe tetraplegjik, i cili nuk është ekonomikisht aktiv, si dhe nuk përfiton të ardhura nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror, vlerësohet periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni, barrëlindje, aksidenti në punë dhe sëmundje profesionale, dhe sigurimi shëndetësor.

Kontributi paguhet në bazë të pagës minimale, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit të detyrueshëm shoqëror, dhe përballohet nga Buxheti i Shtetit.

4/2. Shërbimi Social Shtetëror, mbështetur në informacionin e dërguar nga njësitë e qeverisjes vendore, harton listat e kujdestarëve përfitues, çdo vit dhe sa herë ndryshon kjo listë, në bazë të të cilave përllogariten fondet, që nevojiten për pagesën e kontributit për këtë kategori personash. Procedurat për zbatimin e kësaj pike përcaktohen në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.".

2. Efektete financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në shumën 17 000 000 (shtatëmbëdhjetë milionë) lekë, për pagesën e kontributit për sigurimet e detyrueshme shoqërore shëndetësore, për vitin 2009, për kujdestarinë, të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të viti 2009.

3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Financave, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet finaciare nga data 1 mars 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.327, datë 12.3.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.78, DATË 4.2.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MASËN, KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRFITIMIT TË NJË PAKETE TË VEÇNTË HIGJIENO-SANITARE PËR INVALIDËT PARAPLEGJIKË DHE TETRAPLEGJIKË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës e Shqipërisë" dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 "Për buxhetin e vitit 2009", me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit nr.78, datë 4.2.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, masa "…12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në muaj…" zëvendësohet me "… 16 000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj…".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2009, në shumën prej 140 000 000 (një qind e dyzet milionë) lekësh, të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të vitit 2009.

3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shnaseve të Barabarta, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet finaciare nga data 1 mars 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.328, datë 12.3.2009

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.618, DATË 7.9.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11, pika 1 e 20, pika 3 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, të nenit 15 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të pikës 2 të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shpipërisë" dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 "Për buxhetin e vitit 2009", me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.618, datë 7.9.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

1. Në fund të pikës 13/1 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Periudha e shërbimit si kujdestar, për invalidin paraplegjik dhe tetraplegjik, i cili nuk është

ekonomikisht aktiv, si dhe nuk përfiton të ardhura nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror, vlerësohet periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni, barrëlindje, aksidenti në punë dhe sëmundje profesionale dhe sigurimi shëndetësor.

Kontributi paguhet në bazë të pagës minimale, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit të detyrueshëm shoqëror dhe përballohet nga buxheti i shtetit.".

2. Pas pikës 26 shtohet pika 26/1, me këtë përmbajtje:

"26/1 Për zbatimin e pikës 13/1, Shërbimi Social Shtetëror, mbështetur në informacionin e dërguar nga njësitë e qeverisjes vendore, harton listat e kujdestarëve përfitues, çdo vit dhe sa herë ndryshon kjo listë, në bazë të të cilave përllogariten fondet, që nevojiten për pagesën e kontributit për këtë kategori personash.".

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në shumën 134 000 000 (njëqind e tridhjetë e katër milionë) lekë, për pagesën e kontributit për sigurimet e detyrueshme, shoqërore e shëndetësore, për vitin 2009, për kujdestarin, të përballohen nga fondi rezervë Buxhetit të Shtetit.

4. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Financave, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet finaciare nga data 1 mars 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.243 , datë 22.4. 2009

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR.160, DATË 25.1.2007 "PËR PROCEDURAT E NDALIMIT, SEKUESTRIMIT DHE KONFISKIMIT TË MJETEVE PËR KUNDËRVAJTJE ADMINISTRATIVE", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 201, 203, 206, 209, 210 e 211 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", nenit 7 të ligjit nr. 7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative", i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000, rregullores "Për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, me qëllim unifikimin e procedurave për sekuestrimin, konfiskimin dhe tjetërsimin e mjeteve,

UDHËZOJ:

1. Në pikën 5 dhe 13, pas fjalëve "Rezervave" të shtohen fjalët "Materiale".

2. Pas pikës 5, të shtohet pika 5.1, me këtë përmbajtje:

"5.1 Në administrim për shitje, të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, kalojnë edhe mjetet, ndalimi i të cilave është bërë sipas nenit 203 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.".

3. Germa "a" e pikës 8 të ndryshohet si më poshtë:

"a) Shefi i Sektorit të Rendit të Policisë së Qarkut – kryetar;".

4. Pika 8/2 shfuqizohet.

5. Pas pikës 8/3, të shtohet pika 8/4, me këtë përmbajtje:

"4. Përcaktimin e peshës reale të mjeteve me mangësi të dukshme.".

6. Fjalia e parë e pikës 9 ndryshohet si më poshtë vijon:

"9. Mjetet e kategorizuara sipas pikës 8/3, u shiten shoqërive të licencuara për shkatërrim mjetesh, për skrap ose për shkrirje metalesh, pasi të hiqen nga qarkullimi, sipas nenit 102 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.".

7. Pika 11 ndryshohet si më poshtë vijon:

“11. Transportimi i mjeteve të kategorizuara sipas pikës 8/1, për në Rezervat Materiale të Shtetit, bëhet me mjetet e Ministrisë së Brendshme.

Transportimi i mjeteve të kategorizuara sipas pikës 8/3, bëhet nga Blerësi Publik.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e tij edhe për mjetet e konfiskuara deri në hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

VENDIM
Nr.9, datë 1.4.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datën 23.01.2009, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.35/20 Akti që i përket:

Kërkues: Përparime Shehu

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit, përfaqësuar nga z. Zef Macaj me autorizim

KËSHILLI QARKUT GJIROKASTËR, në mungesë.

ZYRA E PËRMBARIMIT GJIROKASTËR, në mungesë.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, nr.371, datë 21.6.1996 të Gjykatës së Rrethit Tepelenë dhe vendimit nr.739, datë 25.4.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/1, 131/f, 132/1, 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27 e 28 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetutese”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fehmi Abdiu, kërkuesin që u shpreh për pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar që e la në vlerësimin e gjykatës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kërkuesja është e vetmja trashëgimtare testamentare e Mynyvere Shehut. Ndër të drejtat pasurore të trashëgimlënëses kanë qenë dhe ato të rrjedhura nga vendimi gjyqësor i formës së prerë nr.371, datë 21.6.1996 i Gjykatës së Rrethit Tepelenë, me të cilin është vendosur pranimi i kërkesës së paditëses Mynevere Shehu dhe detyrimi i të padituri, Këshilli i Rrethit Tepelenë, t'i paguajë paditëses shumën 530.941 lekë. Shuma e përfituar nga kërkuesja rrjedh nga vlerësimi i shtëpisë së shtetëzuar në vitin 1967.

Vendimi gjyqësor nr.371, datë 21.6.1996 i Gjykatës së Rrethit Tepelenë ka marrë formë të prerë më datë 5.7.1996. Me vendimin nr.20, datë 15.7.1998, Gjykata e Rrethit Tepelenë ka lëshuar urdhrin për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor.

Në datën 21.11.2001, Zyra e Përmbarimit Tepelenë ka vendosur të pushojë ekzekutimin e titullit ekzekutiv për shkak të riorganizimit të pushtetit vendor dhe suprimimit të Këshillit të Rrethit Tepelenë.

Në datën 20.3.2006, Zyra e Përmbarimit Gjirokastër (pas riorganizimit) ka rivënë në ekzekutim këtë titull ekzekutiv.

Në datën 25.4.2008, me vendimin nr.739, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër ka vendosur detyrimin e Këshillit të Qarkut Gjirokastër për shpërblimin e paditëses për mosekzekutimin në kohë të detyrimit që rrjedh nga përmbajtja e vendimit gjyqësor nr.371, datë 21.6.1996, në një shumë prej 1.237.336 lekë. Për këtë vendim është lëshuar urdhri i ekzekutimit nr.244, datë 27.6.2008.

Kërkuesja i është drejtuar Zyrës së Përmbarimit për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në fjalë. Në bazë dhe për zbatim të urdhrit të ekzekutimit nr.20, datë 15.7.1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tepelenë, Zyra e Përmbarimit ka proceduar me lajmërimin për ekzekutim vullnetar të urdhrit të ekzekutimit deri në aplikimin e sanksioneve ligjore ndaj debitorit të parashikuar në nenin 606 të Kodit të Procedurës Civile. Përpjekjet për ekzekutim nga kjo zyrë kanë rezultuar të pasuksesshme.

II

Kërkuesja ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara nga ligji, brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ. Për këtë ka hasur në refuzimin dhe pasivitetin e organeve kompetente për të ekzekutuar vendimin e formës së prerë, pasi Këshilli i Qarkut Gjirokastër ka nxjerrë pengesa artificiale për mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore, kurse Zyra e Përmbarimit nuk përmbush detyrimet ligjore proceduriale.

Përfaqësuesi i Zyrës Përmbarimit ka pretenduar se ka ndjekur të gjitha procedurat e kryerjes së veprimtarisë përmbarimore në përputhje me ligjin, por është penguar në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, sepse sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.355, datë 2.6.1998 "Për procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet që prekin Buxhetin e Shtetit", organi kompetent për shlyerjen e detyrimeve financiare rezulton Ministria e Financave, e cila nuk ka qenë palë në proces.

Këshilli i Qarkut Gjirokastër ka pretenduar se për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, është penguar nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.355, datë 2.6.1998 "Për procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet që prekin Buxhetin e Shtetit", sipas të cilit për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për kthimin ish-pronarëve të objekteve të privatizuara mbas shtetëzimit, si dhe të gjitha detyrimet dhe të drejtat që rrjedhin nga ky veprim, kompetente është Ministria e Financave.

III

Lidhur me pretendimin e kërkuesit për mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë brenda afatit të arsyeshëm

Në kërkesën e paraqitur para Gjykatës Kushtetuese ka rezultuar se kërkuesja ka kërkuar ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr.371, datë 21.6.1996 të Gjykatës së Rrethit Tepelenë, për të cilin, me vendimin nr.20, datë 15.7.1998 të Gjykatës së Rrethit Tepelenë, është lëshuar urdhri për ekzekutim. Veç këtij vendimi, me vendimin nr.739, datë 25.4.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër ka vendosur detyrimin e Këshillit të Qarkut Gjirokastër për shpërblimin e paditëses për mosekzekutimin në kohë të detyrimit që rrjedh nga përmbajtja e vendimit gjyqësor nr.371, datë 21.6.1996, në një shumë prej 1.237.336 lekësh. Edhe për këtë vendim është lëshuar urdhri i ekzekutimit nr.244, datë 27.6.2008.

Kërkuesja i është drejtuar Zyrës së Përmbarimit për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në fjalë, por veprimet e saj kanë rezultuar të pasuksesshme, ndonëse janë shtrirë në një periudhë kohore 1998-2008.

Gjykata Kushtetuese ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë si element i procesit të rregullt ligjor, duke theksuar se e drejta për të kërkuar ekzekutimin brenda një afati të arsyeshëm të një vendimi gjyqësor të formës së prerë duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (*vendimi nr.6 datë 31.3.2006 i Gjykatës Kushtetuese*).

Parimet kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, të përcaktuara në nenet 42 dhe 142/3 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj.

Ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre. Shteti i së drejtës, si një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike, përmban në vetvete detyrimin e autoriteteve publike për të vënë në zbatim urdhërimet ose vendimet gjyqësore të formës së prerë.

Gjykata Kushtetuese ka pranuar se ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Për këtë problem, autoritetet shtetërore nuk mund të përmendin mungesën e fondeve si justifikim për të mos respektuar një detyrim financiar që vjen nga një vendim gjyqësor. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*vendimi nr.43, datë 19.12.2007 i Gjykatës Kushtetuese)*.

Veç sa më sipër, Gjykata ka rikonfirmuar qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces.

Ekzekutimi i vendimeve brenda afatit të arsyeshëm ka qenë objekt i shqyrtimit të vazhdueshëm edhe nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), e cila në jurisprudencën e saj ka rikonfirmuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e aplikantit dhe autoriteteve përkatëse, si dhe interesin e aplikantit. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, volumin e provave shkresore. Përsa i përket sjelljes së aplikantit/kërkuesit, GJEDNJ ka mbajtur qëndrimin se përdorimi nga ana e aplikantit i të gjitha procedurave të parashikuara nga e drejta e brendshme, me qëllim sigurimin e mbrojtjes, nuk mund të përdoret si argument kundër tij. Përsa i përket sjelljes së autoriteteve, edhe në ato sisteme ligjore, të cilat zbatojnë parimin se iniciativat procedurale u takojnë palëve, përsëri gjykatat kanë detyrimin për të siguruar progresin e gjykimeve me shpejtësi të mjaftueshme (*vendimi "Cravcenko kundër Moldavisë", datë 15.4.2008, prg. 45 i GJEDNJ*).

Në çështjen objekt shqyrtimi merr rëndësi ballafaqimi i këtyre standardeve me rrethanat konkrete. Gjatë hetimit të çështjes rezultoi se vendimi gjyqësor i formës së prerë nr.371, datë 21.6.1996 i Gjykatës së Rrethit Tepelenë, përcakton detyrimin e të padituri, Këshilli i Rrethit Tepelenë t'i paguajë paditëses shumën 530.941 lekë. Me daljen e ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", këshillat e rretheve janë shkrirë (suprimuar). Me riorganizimin e pushtetit vendor, Këshilli i Qarkut Gjirokastër, si institucion i cili ka marrë përsipër detyrimet e trashëguara nga ish-këshilli

i rrethit Tepelenë, nuk ka pranuar të ekzekutojë vendimet gjyqësore me arsyetimin se nuk është ai organi kompetent për shlyerjen e detyrimit financiar në çështjen në fjalë.

Për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, kërkuesja i është drejtuar Zyrës së Përmbarimit Gjirokastër, Këshillit të Qarkut Gjirokastër dhe Ministrisë së Financave. Duke hasur në zvarritje të vazhdueshme dhe të gjata për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.371, datë 21.06.1996 të Gjykatës së Rrethit Tepelenë, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër për detyrimin e të padituri, Këshilli i Qarkut Gjirokastër, për të shpërblyer për mosekzekutimin në kohë të detyrimit që rrjedh nga përmbajta e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.371, datë 21.06.1996.

Gjykata Kushtetuese konstaton se vendimi nr.739, datë 25.4.2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, për të cilin kërkuesja kërkon ekzekutimin edhe pse daton në vitin 2008, është në lidhje integrale me vendimin gjyqësor të formës së prerë nr.371, datë 21.6.1996 të Gjykatës së Rrethit Tepelenë, sepse si pasojë e mosekzekutimit të vendimit të parë gjyqësor, ka ardhur dhe kërkesa e kërkueses për shpërblim, e cila ka pasuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë që ka rënduar më tej pozitën financiare të debitorit. Pala e interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit, nuk ka ngritur pretendime që e kundërshtojnë këtë fakt.

Edhe pas vendimit të dytë, kërkuesja ka vazhduar përpjekjet për ekzekutim të vendimeve duke iu drejtuar Zyrës së Përmbarimit Gjirokastër, Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit pranë Ministrisë së Drejtësisë, disa organeve të administratës publike si Ministrit të Financave, Avokatit të Popullit, Këshillit të Ministrave.

Sa më lart, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkuesja ka përdorur të gjitha mjetet e nevojshme nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtën e shkelur për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.371, datë 21.6.1996 të Gjykatës së Rrethit Tepelenë dhe vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.739, datë 25.4.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

Lidhur me pretendimin e subjektit të interesuar se vendimi i Këshillit të Ministrave nr.335 përcakton Ministrinë e Financave si organ kompetent për ekzekutimin e vendimit dhe se kjo zyrë nuk legjitimohet për ndërhyrje pranë një organi, i cili nuk ka qenë palë e vendimit gjyqësor.

Vendimi nr.371, datë 21.6.1996 i Gjykatës së Rrethit Tepelenë njeh si palë debitore Këshillin e Rrethit Tepelenë, ndërsa vendimi nr.739, datë 25.4.2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër njeh si palë debitore Këshillin e Qarkut Gjirokastër. Përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit pretendoi se përmbaruesit gjyqësor nuk mund të legjitimoheshin për t'iu drejtuar Ministrisë së Financave, sepse vendimet gjyqësore nuk e përfshijnë këtë organ si palë debitore.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.335, datë 2.6.1998 "Për procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet që prekin buxhetin e shtetit", pika 2 përcakton se: *"Ministria e Financave, me fondin që i vihet në dispozicion në buxhetin e çdo viti, zbaton vendimet gjyqësore që lidhen drejpërdrejt me detyrimet e buxhetit të shtetit dhe jo me detyrimet e institucioneve buxhetore. Në këto vendime përfshihen*:

a)…

b) vendimet gjyqësore për kthimin ish-pronarëve të objekteve të privatizuara mbas shtetëzimit si dhe të gjitha detyrimet dhe të drejtat që rrjedhin nga ky veprim".

Ky vendim, duke përcaktuar organ kompetent Ministrinë e Financave, ndryshe nga sa përcaktojnë ligji dhe vendimet gjyqësore, ka spostuar pozicionin e palës debitore në një proces gjyqësor, përfshirë edhe fazën e ekzekutimit. Ky vendim ka krijuar procedura te mëtejshme jashtë atyre të përcaktuara nga Kodi i Procedurës Civile dhe jashtë kontekstit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore sipas Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata vlerëson se sipas parimit të hieakisë së normave juridike, përcaktuar në nenin 116 të Kushtetutës, aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë Kushtetuta, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, më pas vijojnë ligjet dhe së fundmi aktet normative të Këshillit të Ministrave. Prandaj, në rast përplasjesh dhe dualizimesh midis procedurave të përcaktuara

me ligj dhe atyre të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave si akt normativ, prioritet ka ligji.

Neni 510 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv. Janë tituj ekzekutivë, ndër të tjera, vendimet civile të gjykatës që kanë marrë formë të prerë. Sipas nenit 511, titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim me kërkesën e kreditorit dhe për këtë qëllim lëshohet urdhri i ekzekutimit nga gjykata. Ekzekutimi i një vendimi gjyqësor mund të bëhet fillimisht me ekzekutim vullnetar dhe Kodi i Procedurës Civile parashikon kriteret për këtë qëllim. Sipas nenit 518, lajmërimi duhet ndër të tjera të përmbajë paralajmërimin që i bëhet debitorit se do të fillojë ekzekutimi i detyrueshëm në qoftë se ekzekutimi nuk ekzekutohet vullnetarisht prej tij brenda afatit të caktuar në lajmërim. Po ashtu, sipas nenit 589 të Kodit të Procedurës Civile parashikon se ekzekutimi i detyrimeve në të holla ndaj institucioneve buxhetore bëhet vetëm në llogarinë e tyre përkatëse bankare, në kredi që ata kanë te të tretët dhe kur nuk ka të tilla në llogari të thesarit. Kur institucioni buxhetor nuk ka gjendje në llogarinë bankare, as kredi te të tretët dhe as në thesar, i kërkohet organit epror financiar përkatës të caktojë fondin e nevojshëm në kapitullin e buxhetit të subjektit nga do të shlyhet detyrimi ose financimi të veçantë nga Buxheti i Shtetit.

Sa më sipër, Zyra e Përmbarimit Gjirokastër duhet të ndjekë procedurën ligjore dhe të kërkojë ekzekutimin e vendimeve gjyqësore ndaj palës debitore (palë ndërgjyqëse) që është Këshilli i Qarkut Gjirokastër.

Përfaqësuesi i Zyrës së Përmbarimit pretendoi se kjo zyrë kishte zbatuar dispozitat procedurale mbi ekzekutimin vullnetar deri në gjobitjen e personit të ngarkuar nga ligji për mosekzekutim vullnetar të detyrimit. Vendimi i përmbaruesit gjyqësor për gjobitjen e debitorit është lënë në fuqi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, por Gjykata e Apelit Gjirokastër e ka prishur këtë vendim, duke ndërprerë procedurën e kryerjes së veprimeve përmbarimore të mëtejshme.

Gjykata vlerëson se, pavarësisht nga sa është evidentuar më lart, veprimet e kryera nga përmbaruesi gjyqësor kanë qenë të pamjaftueshme për shkak të mosushtrimit të të gjitha kompetencave nga ana e tij, pasi si subjekt procedural në fushën e ekzekutimit, ai është i pajisur me të gjitha mjetet procedurale që mundësojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv (*vendimi nr.1, datë 19.1.2009 i Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata vlerëson se përmbaruesi gjyqësor i kishte hapësirat ligjore që të mund të kërkonte, deri edhe ndjekjen penale për personat që kanë penguar ekzekutimin e vendimeve pa shkaqe të përligjura.

Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese nuk gjen arsye të bazuara që kanë çuar në mosrealizimin e të drejtës së kërkueses për një proces të rregullt ligjor nëpërmjet refuzimit për zbatim të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.371, datë 21.6.1996 të Gjykatës së Rrethit Tepelenë dhe vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.739, datë 25.4.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe vlerëson se në çështjen objekt shqyrtimi, Zyra e Përmbarimit dhe Këshilli i Qarkut Gjirokastër, i kishin të gjitha mundësitë që gjatë gjithë periudhës nga dita e marrjes formë të prerë të vendimeve e në vazhdim t'i ekzekutonin ato.

Si përfundim, në vijim të arsyetimit të mësipërm, në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata Kushtetuese konstaton se mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë brenda afatit të arsyeshëm ka sjellë cenimin e së drejtës së kërkueses për një proces të rregullt ligjor.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja "f" të Kushtetutës, nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.371, datë 21.6.1996 të Gjykatës së Rrethit Tepelenë dhe vendimit nr.739, datë 25.4.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Xhezair Zaganjori, Kujtim Puto, Sokol Sadushi, Petrit Plloçi, Fehmi Abdiu, Sokol Berberi

VENDIM
Nr.10, datë 2.4.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese		
Fehmi Abdiu	Anëtar i	“	“
Kujtim Puto	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtar i“	“	
Sokol Sadushi	Anëtar i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datë 15.10.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.14/3Akti, që i përket:

KËRKUES: Artur Rrapaj, përfaqësuar nga Av. Qazim Gjonaj, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:

ZYRA E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM, përfaqësuar nga prokurori Hysen Keta, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr.169, datë 4.5.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr.173, datë 27.5.2005 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.330, datë 19.5.2006 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 131/f, 134/1/g dhe 42/1/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 1, 5 dhe 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) dhe neni 4 i Protokollit nr.7 të KEDNJ, nenet 27, 28, 29, 30, 39, 42 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe

funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Plloçi, përfaqësuesin e kërkuesit, që kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Më datë 28.6.1998, në vendin e quajtur "Izvor", pranë fshatit Ramicë të rrethit Vlorë, persona të armatosur dhe të maskuar i kanë prerë rrugën automjetit me të cilin udhëtonte inspektori i policisë I.G., kanë rrëmbyer këtë të fundit dhe kanë plagosur në të dyja këmbët shtetasin Dh.G..

Më datë 6.7.1998 është regjistruar çështja penale me numër 175 dhe pas kryerjes së hetimeve paraprake, me vendimin datë 7.9.1998 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, kërkuesi Artur Rrapaj është vënë nën akuzë dhe është arrestuar për kryerjen e veprave penale të rrëmbimit dhe mbajtjes peng të personit, plagosjes së rëndë me dashje dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, parashikuar përkatësisht nga nenet 109/1, 88/1 dhe 278/2 të Kodit Penal.

Me vendimin datë 6.10.1998 të prokurorit, për mungesë të provave të mjaftueshme, është vendosur pushimi i procedimit penal ndaj kërkuesit dhe lirimi i tij nga dhomat e paraburgimit.

Me vendimin datë 27.3.2000 të prokurorit, për arsye se pas kryerjes së hetimeve paraprake nuk u bë i mundur zbulimi i autorëve, është vendosur pezullimi i hetimeve lidhur me këtë ngjarje.

Me vendimin datë 25.1.2001 të prokurorit është shfuqizuar vendimi i pezullimit, kanë rifilluar hetimet dhe, në përfundim të tyre, kanë rezultuar si autorë të ngjarjes dhe janë dërguar për gjykim shtetasit Reiz Haxhiraj, Artur Rrapaj e Zihni Hoxha.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.169, datë 4.5.2004 ka deklaruar fajtor kërkuesin Artur Rrapaj për kryerjen e veprave penale të rrëmbimit dhe mbajtjes peng të personit në rrethana lehtësuese në bashkëpunim, plagosjes së lehtë me dashje dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve, e ka dënuar atë me 13 vjet burgim.

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.173, datë 27.5.2005 ka vendosur të ndryshojë vendimin nr.169, datë 4.5.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe duke e gjykuar çështjen në fakt, të deklarojë fajtor të pandehurin Artur Rrapaj për kryerjen e veprave penale të rrëmbimit dhe mbajtjes peng të personit në rrethana rënduese në bashkëpunim, plagosjes së rëndë me dashje dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, dhe në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, duke bërë bashkimin e dënimeve, ta dënojë atë përfundimisht me 15 vjet burgim.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, me vendimin nr.330, datë 19.5.2006 ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga i gjykuari Artur Rrapaj.

Kërkuesi pretendon se vendimet e gjykatave janë rezultat i një procesi të parregullt ligjor dhe kërkon shfuqizimin e tyre, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur:

- Gjykatat kanë cenuar parimin *ne bis in idem*, pasi kërkuesi me këto vendime është ndjekur penalisht dhe është dënuar në mënyrë të përsëritur, për të njëjtat vepra penale për të cilat ishte pushuar më parë procedimi penal, pa u shfuqizuar vendimi i pushimit. Në këtë mënyrë gjykatat kanë cenuar të drejtat e garantuara nga neni 34 i Kushtetutës dhe neni 4 i protokollit nr.7 të KEDNJ.

- Gjykatat kanë cenuar parimin *ne bis in idem* edhe sepse lidhur me akuzën e armëmbajtjes pa leje, kërkuesi është dënuar më parë me vendim gjykate të formës së prerë.

- Gjykatat kanë cenuar të drejtën e mbrojtjes gjatë procesit penal, sanksionuar nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ, për arsye se kërkuesi është vënë nën akuzë dhe është gjykuar pa pasur dijeni se ndaj tij kishte nisur një procedim penal.

- Gjykata e Apelit Vlorë ka cenuar parimin e paanshmërisë, duke mos mënjanuar nga gjykimi i

çështjes një gjyqtar që kishte lidhje me palën e dëmtuar nga vepra penale.

- Gjykata e Lartë duke qenë se në rastin e kërkuesit konstatohen shkelje të rënda të parimeve dhe normave kushtetuese, ishte e detyruar të kalonte çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore.

Përfaqësuesi i Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm kërkoi përpara Gjykatës Kushtetuese rrëzimin e kërkesës, duke parashtruar:

- Pretendimi i kërkuesit se është cenuar parimi *ne bis in idem* nuk është i bazuar. Neni 34 i Kushtetutës garanton të drejtën e individit për të mos u dënuar nga gjykata për një vepër penale për të cilën është deklaruar i pafajshëm me një vendim përfundimtar të ligjshëm. Në rastin në shqyrtim, vendimi i pushimit nuk është dhënë nga gjykata, por jemi para një vendimi të ndërmjetëm të marrë nga prokuroria në fazën e hetimeve paraprake. Në asnjë prej dispozitave të Kodi i Procedurës Penale nuk parashikohet si detyrim shfuqizimi i vendimit të prokurorit për pushimin e çështjes, aq më tepër të përcaktohen rastet kur duhet ndërmarrë ky veprim.

- Në lidhje me pretendimin se kërkuesi është dënuar për të njëjtën armë nga gjykatat është vlerësuar se përdorimi i armës është bërë në kohë, vende e ngjarje të ndryshme kriminale.

- Kërkuesi ka pasur dijeni për ushtrimin e ndjekjes penale ndaj tij. Po ashtu, gjykimi i çështjes është bërë në prani të mbrojtësit dhe të gjitha provat janë shqyrtuar në seancë gjyqësore, duke u çmuar e vlerësuar nga gjykata sipas kërkesave të Kodit të Procedurës Penale.

- Pretendimi për cenim të parimit të paanshmërisë nga Gjykata e Apelit Vlorë nuk qëndron, pasi lidhja midis personit të dëmtuar nga vepra penale dhe gjyqtarit, që paraqitet si shkak për heqjen dorë të këtij të fundit nga gjykimi i çështjes, nuk është e tillë që bie ndesh me kërkesat e neneve 16 e 17 të Kodit të Procedurës Penale.

II

Gjykata Kushtetuese i vlerëson pretendimet e kërkuesit në kuadër të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të KEDNJ-së, si dhe në këndvështrimin e respektimit të disa të drejtave të tjera kushtetuese individuale që parashikohen në nenet 31 dhe 34 të Kushtetutës, të cilat shfaqen njëkohësisht edhe si aspekte të rëndësishme të një procesi të rregullt ligjor.

*1. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit **ne bis in idem**.*

*a) Kërkuesi pretendon se gjykatat kanë cenuar parimin **ne bis in idem**, sepse ai është ndjekur penalisht dhe dënuar në mënyrë të përsëritur për të njëjtat vepra penale për të cilat ishte pushuar procedimi penal, pa u shfuqizuar më parë vendimi i pushimit.*

Gjykata Kushtetuese rithekson me këtë rast se parimi *ne bis in idem* është njohur si një prej të drejtave të njeriut të mbrojtura nga Kushtetuta dhe nga instrumentet kryesore juridike të brendshme e ndërkombëtare që rregullojnë marrëdhëniet në fushën penale, si dhe përgjegjësinë për kundërvajtje. Sipas këtij parimi, askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht për një vepër penale për të cilën është shpallur më parë i pafajshëm ose është dënuar me një vendim gjyqësor përfundimtar.

Siç ka vlerësuar kjo Gjykatë edhe në çështje të tjera të kësaj natyre, ideja e parimit *ne bis in idem* nuk qëndron tek zbatimi dy a më shumë herë i së njëjtës normë penale, por tek mosgjykimi e mosdënimi përsëri i subjektit për të njëjtën vepër penale, për të cilën ai është dënuar më parë me një vendim të formës së prerë nga një gjykatë e ligjshme (*vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.5, datë 8.3.2005*).

Gjykata Kushtetuese konstaton se me aktakuzën datë 7.9.1998 kërkuesi u akuzua nga organi i prokurorisë për kryerjen në bashkëpunim të veprave penale të rrëmbimit dhe mbajtjes peng të personit, plagosjes së rëndë me dashje dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, parashikuar nga nenet 109/1, 88/1 e 278/2 të Kodit Penal, lidhur me ngjarjen e rrëmbimit të shtetasit I.G. dhe plagosjes së vëllait të tij Dh.G., ngjarje e ndodhur më datë 28.6.1998. Pas kryerjes së hetimeve paraprake, me vendim të prokurorit datë 6.10.1998 u vendos *"pushimi i procedimit penal ndaj të pandehurit Artur Rrapaj, për mungesë të provave të mjaftueshme"*. Në atë periudhë u kryen një sërë hetimesh paraprake dhe meqenëse nuk u bë i mundur zbulimi i autorëve, me vendimin datë 27.3.2000, prokurori pezulloi hetimet në lidhje me këtë ngjarje. Me vendimin datë 25.1.2001 të prokurorit, u shfuqizua vendimi i pezullimit, rifilluan hetimet dhe në përfundim të tyre u akuzuan si autorë të ngjarjes shtetasit Reiz Haxhiraj, Artur Rrapaj e Zihni Hoxha.

Neni 328 i Kodit të Procedurës Penale ka parashikuar rastet kur mund të vendoset pushimi i akuzës ose çështjes nga prokurori dhe një nga këto raste është ai i parashikuar në pikën "dh" (del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai). Në rastin e parë, pra kur "del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën", nga hetimi është vërtetuar pafajësia e të pandehurit, kurse në rastin e dytë, pra kur "nuk provohet që e ka kryer ai", fajësia e të pandehurit mbetet e dyshimtë. Në të dyja rastet kemi pushim të akuzës ndaj personit të marrë në cilësinë e të pandehurit, por jo pushim të çështjes, sepse vepra penale ekziston, autori i saj nuk dihet dhe hetimet për gjetjen e autorit të veprës penale vazhdojnë. Rasti kur i pandehuri *nuk e ka kryer veprën penale*, ndryshon nga rasti kur *nuk provohet që veprën e ka kryer ai*, sepse në rastin e parë pafajësia e tij është e provuar dhe e qartë, ndërsa në rastin e dytë fajësia nuk provohet, por mbetet e dyshimtë dhe dyshimi është në favor të të pandehurit.

Gjykata Kushtetuese vëren se dispozita e nenit 135 të Kushtetutës, sipas të cilës *pushteti gjyqësor ushtrohet nga ëgjykatat] Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë*, në aspektin procedural penal, do të thotë se një person nuk mund të deklarohet fajtor për kryerjen e një vepre penale dhe as mund t'i jepet një dënim penal, pa një vendim gjykate të marrë në bazë të ligjit. Gjykata Kushtetuese vë në dukje se funksioni kushtetues i dhënies së drejtësisë nga gjykatat është i ndryshëm nga funksioni i ndjekjes penale që ushtron prokurori. Kur ushtron ndjekjen penale, prokurori vetëm mbledh provat për të vërtetuar akuzën dhe verifikon nëse ndodhet në kushtet që e detyrojnë të pushojë akuzën ose çështjen penale, apo ta dërgojë çështjen në gjykatë. Gjykata, në përfundim të procesit, vendos për deklarimin fajtor ose të pafajshëm të të pandehurit, që do të thotë se, në ushtrim të funksionit të dhënies së drejtësisë në kontekstin penal, është gjykata që vendos për themelin e akuzës së ngritur nga prokurori. Për pasojë, pushimi i akuzës ose i çështjes penale nga prokurori, në vetvete, nuk barazohet me pafajësinë e të pandehurit (*vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.14, datë 21.7.2008*).

Në rastin e parashikuar nga pika "dh" e nenit 328 të Kodit të Procedruës Penale, çështja penale është e hapur dhe hetimet vazhdojnë, pasi autori nuk është gjendur ende. Organi i akuzës ka detyrimin të vazhdojë punën për zbardhjen e ngjarjes dhe, me gjetjen e provave të reja, prokuroria mund të ngrejë akuzë edhe ndaj personit për të cilin kishte pushuar më parë procedimin penal, por është gjykata ajo që do të vendosë mbi fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit, me një vendim përfundimtar.

Sa më sipër Gjykata Kushtetuese vlerëson se vendimi i prokurorit për pushimin e çështjes penale nuk përfaqëson një vendim përfundimtar, të formës së prerë, të dhënë nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe, në këtë kuptim, nuk ka cenim të parimit *ne bis in idem*.

*b) Kërkuesi pretendon se parimi **ne bis in idem** është shkelur edhe sepse, lidhur me akuzën e armëmbajtjes pa leje ai ishte dënuar më parë me një vendim penal të formës të prerë dhe, po për të njëjtën armë, është dënuar përsëri nga gjykatat.*

Gjykata Kushtetuese konstaton se me vendimin penal të formës së prerë nr.95, datë 2.9.1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, kërkuesi Artur Rrapaj është dënuar me 4 muaj e gjysëm burgim për kryerjen e veprës penale të armëmbajtjes pa leje, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal. Ngjarja së cilës i referohet ky vendim ka ndodhur në datën 10.7.1998 në lokalin e shtetasit M.Sh., ku kërkuesi ka qëlluar me armë dhe më pas është larguar duke lënë në lokal armën, konkretisht një automatik nr.2006233. Përsa i përket armës me të cilën është qëlluar në ngjarjen objekt gjykimi, nga aktekspertimi datë 21.1.1999 i gëzhojave të gjetura në vendngjarje, si dhe nga vendimi i pushimit të procedimit penal datë 6.10.1998, rezulton se këto gëzhoja nuk janë qitur nga arma e sekuestruar në ngjarjen e ndodhur në lokalin e shtetasit M.Sh., vepër penale për të cilën kërkuesi kishte vuajtur dënimin penal përkatës.

Siç u përmend më lart, ideja e parimit *ne bis in idem* nuk qëndron tek zbatimi dy a më shumë herë i të njëjtës normë penale, por te mosgjykimi e mosdënimi përsëri i subjektit për "të njëjtën vepër penale", për të cilën ai është dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë. Kriteri "e njëjta vepër" i referohet të njëjtit veprim, sjellje, fakt, vepër penale dhe kualifikim ligjor të tyre, të cilat formojnë bazën e kësaj vepre dhe për të cilin personi është dënuar apo liruar. Nëse gjenden elemente të njëjta parimi *ne bis in idem* ndalon çdo dënim tjetër apo procedim të mëtejshëm (*vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.5, datë*

8.3.2005).

Duke u nisur nga interpretimet e mësipërme, rezulton se parimi *ne bis in idem* nuk mund të gjejë zbatim në rastet kur të dy veprat penale nuk kanë elemente të njëjtë. Parimet e sanksionuara në nenin 34 të Kushtetutës dhe nenin 4 të protokollit nr.7 të KEDNJ parashikojnë se një person i gjykuar dhe i dënuar me vendim të formës së prerë nuk mund të procedohet dhe të gjykohet përsëri për të njëjtën akuzë, që duhet kuptuar për të njëjtin fakt. Për pasojë, një fakt i ri do të gjykohet normalisht edhe pse është kryer nga i njëjti person dhe ka të njëjtin cilësim ligjor me një fakt tjetër për të cilin ai është dënuar më parë.

Sa më sipër Gjykata Kushtetuese vlerëson se, megjithëse kërkuesi ndodhet përpara akuzave të njëjta, ato jo vetëm që i referohen dy ngjarjeve të ndryshme, por madje nuk i referohen as të njëjtës armë për të cilën ai ka vuajtur dënimin e dhënë nga gjykata. Në këto kushte, as në këtë aspekt nuk kemi cenim të parimit *ne bis in idem*.

2. Lidhur me pretendimin për cenimin e të drejtës së mbrojtjes

Kërkuesi pretendon se, pas kryerjes së dënimit për veprën penale të armëmbajtjes pa leje, ai është larguar jashtë shtetit. Në këtë kohë organi i akuzës ka filluar veprime hetimore duke mbledhur të dhëna kundër tij, pa njoftuar as atë dhe as familjen e tij. Po ashtu, kërkuesi pretendon se nuk ka marrë dijeni për këtë procedim dhe për rrjedhojë, nuk ka pasur mundësi të mbrohet me avokat të zgjedhur as në fazën e hetimeve paraprake, dhe as në gjykimin në shkallë të parë. Për këtë shkak, si mbyllja e hetimeve, ashtu dhe mbrojtja në shkallë të parë rezulton me avokat të caktuar kryesisht çka, sipas tij, e bën procesin të parregullt nga pikëpamja kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese konstaton se e drejta e palëve për të qenë të pranishëm dhe për t'u mbrojtur në procesin gjyqësor janë aspekte të rëndësishme të procesit të rregullt në kuptimin kushtetues. Në mënyrë konstante, në një sërë vendimesh të saj, Gjykata Kushtetese ka pranuar si tregues esencial të një procesi të rregullt penal, ekzistencën e mbrojtjes. Që e drejta e mbrojtjes të jetë reale dhe efektive dhe jo vetëm teorike, ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por përkundrazi, gjykata duhet të marrë të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë, jo vetëm të sigurojë praninë e mbrojtësit në gjykim, por dhe t'i japë atij mundësinë të bëjë mbrojtje reale duke respektuar barazinë e armëve (*vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.5, datë 17.2.2003; nr.33, datë 24.11.2003*). E drejta e gjithkujt të akuzuar penalisht, për të qenë efektivisht i mbrojtur nga një avokat, kur është e nevojshme edhe i caktuar kryesisht, është një nga tiparet themelore të një gjykimi të drejtë.

Gjykata Kushtetuese rithekson se mossigurimi i pjesëmarrjes në gjykim të të akuzuarit në çdo rast, por dhe atëherë kur ky i fundit i fshihet drejtësisë, nuk mund të përligjë zhvillimin e procesit kundër tij pa pjesëmarrjen dhe dëgjimin e mbrojtësit. Parimi i kontradiktoritetit dhe i barazisë së armëve në gjykimin penal kërkon që argumentet e mbrojtjes të paraqiten dhe të dëgjohen njëlloj si ato të prokurorit. Ky parim presupozon që secilës palë duhet t'u ofrohen mundësi të arsyeshme për të paraqitur pretendimet për çështjen, në kushte të tilla që të mos e vënë në disavantazh me palën tjetër (*vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.5, datë 17.2.2003*). Për respektimin e këtyre parimeve, gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, mes të cilave, sipas rastit, rëndësi të veçantë paraqet edhe njoftimi i të pandehurit apo mbrojtësit të tij ligjor për akuzën, ankimin, rekursin, ditën dhe vendin e gjykimit të çështjes, etj. Synim kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e të vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi (*vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.16, datë 8.6.2006; nr.13, datë 21.7.2008; nr.19, datë 18.9.2008*).

Duke e vlerësuar pretendimin e kërkuesit në këndvështrim të standarteve të mësipërme të procesit të rregullt gjyqësor, Gjykata Kushtetuese konstaton se në fazën e hetimeve paraprake organi i akuzës ka marrë të gjitha masat për gjetjen e kërkuesit Artur Rrapaj si në adresën e tij në qytetin e Selenicës, ashtu dhe në banesën e të motrës, në qytetin e Tiranës. Duke mos bërë të mundur gjetjen e tij, organi i akuzës, me arsyetimin se kërkimet janë bërë të plota dhe i akuzuari nuk është gjetur, i ka kërkuar gjykatës të deklarojë ikjen e personit nën hetim, duke i caktuar një avokat kryesisht, të cilit i është komunikuar

aktakuza, është njohur me materialet në ngarkim të kërkuesit dhe e ka përfaqësuar atë në seancën për caktimin e masës së sigurimit.

Gjatë gjykimit të çështjes në shkallë të parë, gjykata ka bërë njoftimin me fletëthirrje dhe ka shtyrë disa herë seancat gjyqësore, për arsye se kërkuesi ka qenë në mungesë dhe nuk ka pasur konfirmim për njoftimin e tij, edhe pse në këto seanca është paraqitur avokati i caktuar kryesisht. Në dosjen gjyqësore është e administruar një fletëthirrje e nënshkruar nga vëllai i kërkuesit, shtetasi Xhaferr Rrapaj, ku deklarohet se i pandehuri Artur Rrapaj është larguar jashtë shtetit. Ky shtetas është paraqitur edhe në seancën gjyqësore datë 10.10.2002, ku ka deklaruar përsëri përpara gjykatës së kërkuesi ndodhet jashtë shtetit dhe se familja ka zgjedhur si avokat për mbrojtjen e tij pikërisht avokatin e zgjedhur kryesisht nga gjykata. Ky avokat ka realizuar mbrojtjen e kërkuesit në të gjithë procesin e zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë, ka kundërshtuar provat e akuzës, i ka interpretuar ato në favor të klientit të tij, duke i kërkuar gjykatës që përfundimisht të shpallë klientin e tij të pafajshëm. Është po ky avokat që ka ushtruar edhe të drejtën e ankimit në gjykatën e apelit dhe ka marrë pjesë edhe në seancën e parë të zhvilluar në këtë gjykatë. Më tej, gjatë gjithë procesit të zhvilluar në Gjykatën e Apelit Vlorë rezulton se kërkuesi është përfaqësuar nga avokati i zgjedhur personalisht prej tij me prokurën datë 28.1.2005.

Gjykata Kushtetuese konstaton se, ndryshe nga sa pretendohet, organi i prokurorisë gjatë fazës së hetimeve paraprake, dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë gjatë gjykimit të çështjes, kanë përmbushur të gjitha detyrimet ligjore që u ngarkohen atyre për të siguruar njoftimin dhe pjesëmarrjen e të pandehurit në hetim dhe gjykim. Në kushtet kur nuk është bërë e mundur gjetja e kërkuesit, familjarët e tij kanë marrë dijeni për zhvillimin e procesit penal dhe kanë deklaruar se ndodhet jashtë shtetit, duke i caktuar edhe avokat gjatë gjykimit të çështjes, gjykata bazuar në dispozitat procedurale ka vendosur zhvillimin e gjykimit në mungesë.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkuesit i është siguruar efektivisht mbrojtja me avokat gjatë këtij procesi dhe për rrjedhojë, nuk e gjen të mbështetur pretendimin për cenimin e të drejtës së mbrojtjes.

3. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë nga Gjykata e Apelit Vlorë

Kërkuesi pretendon se Gjykata e Apelit Vlorë ka cenuar parimin e paanshmërisë, sepse në gjykimin e çështjes ka marrë pjesë një gjyqtar, i cili, për shkak të lidhjeve me palën e dëmtuar nga vepra penale, nuk duhet të ishte në përbërje të trupit gjykues.

Gjykata Kushtetuese rithekson se është e një rëndësie themelore në një shoqëri demokratike që gjykatat të frymëzojnë besim tek publiku dhe mbi të gjitha te palët në proces. Për këtë qëllim, neni 42 i Kushtetutës kërkon që një gjykatë, e cila përfshihet në sferën e veprimit të tij (nenit 42), të jetë e paanshme. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njërës prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo gjithashtu duhet të shikohet që bëhet (*vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.38, datë 15.10.2007*).

Me këtë rast, Gjykata Kushtetuese përsërit se respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar testin objektiv, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë, dhe testin subjektiv që ka të bëjë me verifikimin e bindjes apo interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar (*vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.7, datë 11.3.2008; nr.11, datë 2.4.2008; nr.23, datë 4.11.2008*).

Nga pikëpamja e testit objektiv të paanshmërisë, kur shqyrtohet nëse në një çështje të caktuar ekziston një arsye e ligjshme për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm.

Në rastin në shqyrtim, kërkuesi ka vënë në dyshim paanshmërinë e gjyqtarit, duke pretenduar se ai ka lidhje me personin e dëmtuar nga vepra penale. Për pasojë, respektimi i parimit të paanshmërisë në gjykim duhet të ekzaminohet vetëm nga këndvështrimi i testit objektiv, pra nëse ekzistojnë fakte bindëse të cilat ngjallin dyshim legjitim se ky gjyqtar nuk ka qenë i paanshëm.

Konkretisht, kërkuesi ka pretenduar se daja i gjyqtarit dhe personi i dëmtuar nga vepra penale kanë bashkëshortet motra (janë baxhanakë), dhe për shkak të kësaj lidhjeje ky gjyqtar nuk duhet të merrte pjesë në trupin gjykues që ka gjykuar këtë çështje. Për të provuar sa sipër, kërkuesi ka paraqitur një dokument të lëshuar nga organet e pushtetit vendor. Edhe nga ana e Gjykatës Kushtetuese u morën nga organet përkatëse të pushtetit vendor dokumente për të verifikuar këtë pretendim, por përsëri nuk u saktësua plotësisht lidhja e pretenduar. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese vlerëson se lidhja e pretenduar nga kërkuesi nuk është e tillë sa të përbëjë shkak për një dyshim të ligjshëm lidhur me paanësinë e gjyqtarit.

Në aspektin procedural penal, rastet e papajtueshmërisë me funksionin e gjyqtarit në gjykim për arsye lidhjeje familjare, gjinie ose krushqie, janë rregulluar nga Kodi i Procedurës Penale dhe konkretisht neni 16 i këtij Kodi. Në mënyrë të përmbledhur, kjo dispozitë përjashton të marrin pjesë si gjyqtarë në të njëjtin procedim, vetëm personat që janë ndërmjet tyre ose me pjesëmarrësit në gjykim, *bashkëshortë*, *gjini e afërt (...)*, *ose krushqi e afërt (...)*. Nga kategoria e personave krushqi e afërt, kjo dispozitë përjashton ata gjyqtarë që janë midis tyre ose me pjesëmarrësit në gjykim vjehërr, vjehrrë, dhëndër, nuse, kunatë, thjeshtër, thjeshtrë, njerk, njerkë. Në kuptim të kësaj dispozite procedurale, Gjykata Kushtetuese konstaton se lidhja e pretenduar nga kërkuesi nuk përfshihet në rastet e papajtueshmërisë me funksionin e gjyqtarit, parashikuar nga neni 16 i Kodit të Procedurës Penale.

Në rrethanat e mësipërme, Gjykata Kushtetuese vlerëson se shkaku i pretenduar nga ana e kërkuesit nuk është i tillë sa të justifikohet objektivisht anësia e pretenduar e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Vlorë.

4. Lidhur me pretendimin se Gjykata e Lartë, duke qenë se në rastin e kërkuesit konstatohen shkelje të rënda të parimeve dhe normave kushtetuese, ishte e detyruar të kalonte çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore.

Përsa i përket këtij pretendimi Gjykata Kushtetuese, tashmë me një jurisprudencë të konsoliduar në këtë drejtim, vlerëson se bazuar në nenin 433 të Kodit të Procedurës Penale është kompetencë e Kolegjit Penal në dhomën e këshillimit të analizojë dhe vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore.

Nga pikëpamja kushtetuese, vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime, gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i kolegjit për mospranimin e rekursit, vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 19.7.2005*).

Gjykata Kushtetuese vlerëson se në rastin konkret zgjidhja e çështjes me mospranim në dhomë këshillimi, nuk i ka cenuar kërkuesit të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se në tërësinë e tij procesi i zhvilluar në të tre shkallët e gjykimit, në aspektin kushtetues, ka qenë i rregullt. Për pasojë, kërkesa e paraqitur nga kërkuesi Artur Rrapaj duhet të rrëzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Gjergj Sauli, Vitore Tusha, Xhezair Zaganjori, Petrit Plloçi, Sokol Berberi

UDHËZIM
Nr.10, datë 14.4.2009

PËR PROCEDURAT DHE KRITERET E AKREDITIMIT TË VËZHGUESVE TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE NË KZAZ, KQV DHE VNV, NGA KZAZ-JA, PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 28.6.2009

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 21, pika 1, nenit 23, pikat 1/b dhe 2, nenit 6, pikat 1, 3, 4 dhe 6, nenit 7, nenit 116, pika 6, nenit 118 dhe nenit 122, pika 4 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", neni 27, pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative,

UDHËZON:

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë procedurat dhe kriteret e akreditimit të vëzhguesve të subjekteve zgjedhore në komisionin e zonës së administrimit zgjedhor (KZAZ), komisionin e qendrës së votimit (KQV) dhe në vendin e numërimit të votave (VNV), nga komisioni i zonës së administrimit zgjedhor për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2009.

Neni 2
E drejta për të caktuar vëzhgues

1. Çdo parti politike ose koalicion i regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor ka të drejtë të caktojë nga një vëzhgues në KZAZ, KQV dhe për çdo tavolinë në vendin e numërimit të votave, pas regjistrimit të listave shumemërore pranë KQZ-së, sipas rregullave që përcaktohen në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.
2. Për partitë politike që paraqiten në zgjedhje si koalicion, të drejtën për të caktuar vëzhgues e ka vetëm koalicioni.
3. Kandidatët e partive politike nuk kanë të drejtë të caktojnë vëzhgues.
4. Kandidatët e paraqitur nga një grup zgjedhësish në zonat e tyre përkatëse kanë të drejtë të caktojnë nga një vëzhgues në KZAZ, KQV dhe në VNV.

Neni 3
Akreditimi i vëzhguesve

1. KQZ-ja u delegon KZAZ-ve kompetencën për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore të përcaktuar në nenin 2 të këtij udhëzimi.
2. KZAZ-ja bën akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore të parashikuara në nenin 2 të këtij udhëzimi, mbi bazën e të dhënave vetjake të çdo vëzhguesi.
3. Akreditimi mund të përfshijë një ose më shumë qendra votimi brenda zonës së administrimit zgjedhor.
4. Çdo subjekt zgjedhor mund të kërkojë akreditimin vetëm të një vëzhguesi në KZAZ dhe KQV. Vëzhguesi i subjektit zgjedhor, i akredituar në KZAZ, mund ta vëzhgojë procesin zgjedhor dhe në qendrat e votimit të kësaj zone të administrimit zgjedhor.

5. Komisioni i qendrës së votimit në asnjë rast, nuk mund të lejojë një parti politike, koalicion, kandidat të propozuar nga zgjedhesit, të ketë më shumë se një vëzhgues të pranishëm në një qendër votimi.

6. Akreditimi i vëzhguesit në vendin e numërimit të votave, nuk mund të përfshijë më shumë se një VNV. Partitë politike dhe koalicionet mund të kërkojnë, për çdo VNV, akreditimin e një numri vëzhguesish të barabartë me numrin e tavolinave të numërimit, që do të ketë në këto ambiente zgjedhore. Vëzhguesi i KZAZ-së mund të jetë vëzhgues dhe në VNV.

Neni 4
Kushtet për të qenë vëzhgues

Vëzhgues mund të jetë çdo shtetas shqiptar që plotëson kushtet e mëposhtme:

a) gëzon të drejtën për të qenë zgjedhës;

b) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

Neni 5
Kërkesa për të caktuar vëzhgues

1. Kërkesa e subjekteve zgjedhore të parashikuar në nenin 2 të këtij udhëzimi, për akreditimin e vëzhguesve në KZAZ, KQV dhe VNV, i paraqitet KZAZ-së përkatëse.

2. Kërkesa duhet të ketë bashkëngjitur:

a) listën e vëzhguesve që kërkohet të akreditohen pranë KZAZ/KQV/VNV të nënshkruar në çdo faqe nga kryetari i partisë/përfaqësuesi i koalicionit/kandidati i propozuar nga zgjedhesit ose personi i autorizuar prej tyre, sipas modelit të përcaktuar në lidhjen nr. 1 bashkëngjitur këtij udhëzimi;

b) vërtetimin që partia/koalicioni/kandidati i propozuar nga zgjedhësit është i regjistruar në KQZ dhe se ka depozituar listat shumemërore;

c) vetdeklarimin e vëzhguesit për gjendjen gjyqësore.

Neni 6
Personat që bëjnë kërkesën për akreditimin e vëzhguesve

Kërkesa për akreditimin e vëzhguesve dhe dokumentacioni përkatës mund të paraqiten nga personat e autorizuar nga organi drejtues i partisë/përfaqësuesi i koalicionit/kandidati i propozuar nga zgjedhësit. Akti i autorizimit depozitohet në KZAZ.

Neni 7
Afatet e kërkesave për akreditim

1. Kërkesat e subjekteve zgjedhore për akreditimin e vëzhguesve i paraqiten KZAZ-së jo më vonë se 15 ditë para datës së zgjedhjeve.

2. KZAZ-ja miraton kërkesat e subjekteve zgjedhore për akreditim të vëzhguesve jo më vonë se 5 ditë nga paraqitja e tyre.

3. Në rast të evidentimit të mungesave në dokumentacionin e paraqitur, në përmbajtje ose në formë, KZAZ-ja vendos kthimin, me qëllim plotësimin e tij, subjektit zgjedhor përkatës.

4. Dokumentacioni i plotësuar ridepozitohet pranë KZAZ-së brenda 24 orëve nga shpallja e vendimit të kthimit. Verifikimi i dytë i dokumentacionit të riparaqitur pas plotësimit kryhet nga KZAZ-ja brenda 24 orëve nga ridepozitimi i tij.

5. Kundër vendimit të KZAZ-së për refuzimin e kërkesës për akreditim mund të bëhet ankim administrativ pranë KQZ-së sipas përcaktimeve të nenit 124 pika 2 e Kodit Zgjedhor. Ankimi duhet të

paraqitet brenda 3 ditëve nga shpallja e vendimit të refuzimit të kërkesës.

Neni 8
Autorizimi dhe mandati i vëzhguesve

1.Vëzhguesit e miratuar me vendim nga KZAZ-ja përkatëse, regjistrohen nga sekretari i KZAZ-së në librin e protokollit të KZAZ-së dhe pajisen nga ai me autorizimin përkatës, sipas modelit të përcaktuar në Lidhjen nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Vëzhguesit mund të kryejnë vëzhgime vetëm në ambientet zgjedhore të përcaktuara në autorizimin e KZAZ-së.

3. Në autorizimin e lëshuar nga KZAZ- ja duhet të përcaktohet:

a) emri, mbiemri i vëzhguesit;

b) emri i subjektit zgjedhor që e cakton si vëzhgues;

c) qendra e votimit/vendi i numërimit të votave/KZAZ.

Autorizimi mban vulën e KZAZ-së dhe është i firmosur nga kryetari dhe sekretari i KZAZ-së.

Neni 9
Të drejtat dhe detyrimet e vëzhguesve

1. Vëzhguesit kanë këto të drejta:

a) të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve dhe të gjitha fazat e procesit zgjedhor;

b) të paraqesin vërejtje me shkrim para komisioneve të zgjedhjeve për çdo lloj parregullsie që vërejnë;

c) të shohin ose të këqyrin dokumentacionin ose materialet e procesit zgjedhor.

2. Vëzhguesit e subjekteve zgjedhore të akreditуar në vendin e numërimit të votave, përveç të drejtave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, kanë edhe këto të drejta:

a) të njoftojë KZAZ-në (njoftimi bëhet me ngritjen e dorës) në rast të konstatimit të pasaktësive ose parregullsive gjatë procesit të numërimit të votave (gjatë verifikimit të materialeve zgjedhore që gjenden në kutinë e materialeve zgjedhore dhe verifikimit të të dhënave për numrin e fletëve të votimit në kutinë e votimit) sipas nenit 116 të Kodit Zgjedhor;

b) të kundërshtojë vlerësimin e votës së bërë nga numëruesi i parë i grupit të numërimt të votave, sipas përcaktimeve të paragrafit të tretë të pikës 2 të nenit 118 të Kodit Zgjedhor;

c) Të marrin kopje të tabelës përmbledhëse të rezultateve të zgjedhjeve të ZAZ-së, tabelave të rezultateve të qendrave të votimit dhe kopje të procesverbaleve të konstatimit.

3. Vëzhguesit kanë këto detyra:

a) të respektojnë kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe udhëzimet e KQZ-së për vëzhgimin e zgjedhjeve, si dhe vendimet dhe urdhërimet e KZAZ-së ku janë akredituar;

b) të mos bëjnë propagandë për asnjë kandidat, parti ose koalicion në ambientet zgjedhore ;

c) të paraqiten para komisioneve të zgjedhjeve me autorizimin e lëshuar nga KZAZ-ja, të shoqëruar me dokument identifikimi (pasaportë, kartë identiteti);

d) të mos mbajnë shenja dalluese që shërbejnë si propagandë ose që mund të ndikojnë mbi vullnetin e zgjedhësit;

e) të mos dhunojnë të drejtën e votuesit për të votuar në fshehtësi dhe të mos pengojnë procesin e votimit dhe numërimit të votave;

f) vëzhguesit e subjekteve zgjedhore të akreditуar në VNV gjatë procesit të numërimit dhe vlerësimit të votave nga grupet e numërimit janë të detyruar të qëndrojnë në vendin e caktur për ta nga KZAZ-ja;

g) të respektojnë rregullat e etikës në marrëdhëniet me Komisionerët Zgjedhor dhe vëzhguesit e

tjerë, të mos komentojnë me zë dhe të mos debatojnë lidhur me zhvillimin e procesit të votimit.

Neni 10

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Arben Ristani

KZAZ Qarku _____

A U T O R I Z I M

PËR VËZHGUESIT PËR SUBJEKTET ZGJEDHORE

EMRI MBIEMRI _____

SUBJEKTI ZGJEDHOR _____

AKREDITUAR VËZHGUES NË _____
KZAZ/KQV/VNV

NR: _____

KRYETARI N/KRYETARI

VULA E KZAZ-së

DT ____/_____/_____

Udhëzimi Datë

Për procedurat dhe kriteret e akreditimit të vëzhguesve të subjekteve zgjedhore në KZAZ, KQV dhe VNV, nga KZAZ për zgjedhjet për Kuvendin 2009.

1. Vëzhguesit kanë këto të drejta :

a) të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve dhe të gjitha fazat e procesit zgjedhor;
b) të paraqesin vërejtje me shkrim para komisioneve të zgjedhjeve për çdo lloj parregullsie që vërejnë;
c) të shohin ose të kërkyrin dokumentacionin ose materialet e procesit zgjedhor.

2. Vëzhguesit e subjekteve zgjedhore të akreditur në Vendin e Numërit të votave përveç të drejtave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni kanë edhe këto të drejta:

a) të njoftojë KZAZ-në (njoftimi bëhet me ngritjen e dorës) në rast të konstatimit të pasaktësive ose parregullsive gjatë procesit të numërimit të votave (gjatë verifikimit të materialeve zgjedhore që gjenden në Kutinë e Materialeve Zgjedhore dhe verifikimit te te dhenave per numrin e fletëve të votimit në kutinë e votimit) sipas nenit 116 të Kodit Zgjedhor;
b) të kundërshtojë vlerësimin e votës së bërë nga numëruesi i parë i Grupit të Numërimt të Votave, sipas përcaktimeve të paragrafit të tretë të pikës 2 të nenit 118 të Kodit Zgjedhor
c) të marrin kopje të Tabelës përmbledhëse të rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së, tabelave të rezultateve të qendrave të votimit dhe kopje të procesverbaleve të konstatimit.

3. Vëzhguesit kanë këto detyra:

a) të respektojnë kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe udhëzimet e KQZ-së për vëzhgimin e zgjedhjeve, si dhe vendimet dhe urdhërimet e KZAZ-së ku janë akredituar.
b) të mos bëjnë propagandë për asnjë kandidat, parti ose koalicion në në ambjentet zgjedhore ;
c) të paraqiten para komisioneve të zgjedhjeve me autorizimin e lëshuar nga KZAZ-ja, të shoqëruar me dokument identifikimi (pasaporte, karte identiteti)
d) të mos mbajnë shenja dalluese që shërbejnë si propagandë ose që mund të ndikojnë mbi vullnetin e zgjedhësit;
e) të mos dhunojnë të drejtën e votuesit për të votuar në fshehtësi dhe të mos pengojnë procesin e votimit dhe numërimit të votav
f) vëzhguesit e subjekteve zgjedhore të akreditur në VNV gjatë procesit të numërimit dhe vlerësimit të votave nga Grupet e Numërimti jane të detyrar të qëndrojnë në vendin e caktur për ta nga KZAZ-ja
të respektojnë rregullat e etikës në marëdhëniet me Komisionerët Zgjedhor dhe vëzhguesit e tjerë, të mos komentojnë me zë dhe të mos debatojnë lidhur me zhvillimin e procesit të votimit;

Lidhja Nr.1

LISTA E VEZHGUESVE

SUBJEKTI ZGJEDHOR _____

Nr	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	DATËLINDJA	NR.I DOK. ID.	KZAZ/VNV/QENDRA (T) E VOTIMIT QË PËRFSHIN AKREDITIMI
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						
12						
13						
14						
15						
16						
17						
18						
19						
20						
21						
22						
23						
24						
25						

NËNSHKRIMI

DATË 14.04.2009

kryetari i partise /perfaqesuesi i koalicionit/kaniddati i propozuar nga zgjedhesit

VULA

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 27.4.2009
Doli nga shtypi më 27.4.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 24 lekë